



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 415 prot

Vlorë, më 05/3/2020

VENDIM

Nr 9 datë 26 / 02 /2020

**PËR MIRATIMIN E AKT-MARRËVESHJES MBI INVESTIMET DHE
PROJEKTET KULTURORE MES KËSHILLIT TË QARKUT VLORË DHE
BASHKIVE TË QARKUT**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.2, 1.5, neni 31, neni 38 pika 3, të Ligjit nr.9936, datë 02.06.2008 “Për manaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; të Udhëzimit nr.2, datë.06.02.2012, “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” pika 121; Vendimit të Këshillit të Qarkut nr.____ datë 27.12.2019 “Për Miratimin e Planit të Buxhetit të vitit 2020, si dhe të vendimeve të këshillave bashkiakë “Për Miratimin e Planit të Buxhetit të vitit 2020”,

VENDOSI

1. Të miratojë Akt-Marrëveshjen mbi investimet dhe projekteve kulturore mes Këshillit të Qarkut Vlorë dhe bashkive të qarkut.
2. Të autorizojë Kryetarin e Këshillit të Qarkut Vlorë të nënshkruajë marrëveshje me njësitë vendore.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut dhe Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 78 pika 3 të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.